

## Kufizimet e së drejtës së zbritjes së TVSH-së

Ligji 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, i ndryshuar, është ligji bazë, i cili përcakton rregullat dhe aplikimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), e cila zbatohet si një tatim në përqindje mbi çmimin e mallrave dhe shërbimeve dhe bëhet e kërkueshme për t’u paguar pas zbritjes së TVSH-së që rëndon drejtpërdrejt elementët e kostos së mallrave dhe shërbimeve. Sipas përcaktimit ligjor të nenit 2 “Fusha e zbatimit”, tatimit mbi vlerën e shtuar i nënshtrohen të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, të kryera kundrejt pagesës, brenda territorit të RSH, nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë si edhe të gjitha importet e mallrave në territorin e RSH.

Bazuar në nenin 68 “Lindja e së drejtës së zbritjes – Parim i Përgjithshëm”, e drejta e zbritjes lind kur TVSH-ja e zbritshme bëhet e kërkueshme për personin e tatueshëm në bazë të parashikimeve të nenit 32.

TVSH-ja e zbritshme është pikërisht:

- a) TVSH-ja që shkruhet në faturën e lëshuar nga furnizuesi
- b) TVSH-ja e paguar në import

Më tej, bazuar në nenin 69 të ligjit, personi i tatueshëm që kryen furnizime të tatueshme gëzon të drejtën që të zbresë nga TVSH e llogaritur, TVSH-në për furnizimet e marra, në masën që këto furnizime përdoren nga personi i tatueshëm në funksion të transaksioneve të tatueshme që ai kryen.

Por pavarësisht se personi i tatueshëm është në kushtet e zbatimit të nenit 69 dhe 70 të ligjit, nene të cilat saktësojnë transaksionet e tatueshme që ju japin tatimpaguesve të drejtën e zbritjes së TVSH-së, nuk do të lejohet zbritja e TVSH-së për rastet kur ai disponon faturë të lëshuar nga persona të tretë jo në përputhje apo në shkelje të dispozitave të

ligjit siç përcaktohet në nenin 76, pikat 5, 6, 7 të ligjit

Sipas pikës 1 të nenit 74 të ligjit, përjashtohen nga e drejta e zbritjes së TVSH-së shpenzimet për blerjen, importin e mallrave, shpenzimet për shërbimet e përcaktuara shprehimisht në këtë dispozite.

a) shpenzimet e karburantit, përveç rastit kur:

i) qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e karburantit me qëllim për ta shitur atë;

ii) karburanti i blerë është përdorur për nevoja teknologjike në funksion të arritjes së qëllimit primar të biznesit. Në këtë rast, me kushtin që karburanti i blerë të përdoret vetëm për nevoja të veprimtarisë ekonomike të tatueshme dhe për asnjë nevojë tjetër, TVSH-ja kreditohet deri në normativat e përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave sipas veprimtarive;

b) shpenzimet e karburantit të çdo lloji, i përdorur për autoveturat;

c) shpenzimet për autovetura dhe shërbimet në lidhje me to, përveç rasteve kur: i) qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e autoveturave vetëm me qëllim për t’i shitur ato; ii) përdorimi i autoveturave është i vetmi qëllim i veprimtarisë ekonomike (dhënia me qira, shërbimi i taksive, ambulancave dhe veprimtari të ngjashme të kësaj natyre);

ç) shpenzimet për udhëtime e dieta, strehimin në hotele, veprimtari çlodhëse dhe argëtuese, shpenzime luksi dhe të përfaqësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike. Për shpenzimet e përfaqësimit e drejta e zbritjes nuk lejohet për shpenzime përtej normës së lejuar për njohjen e tyre si shpenzim i zbritshëm, në përputhje me ligjin që trajton tatimin mbi fitimin.